



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.252/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Adnan Konushevci dhe Afjete Sada-Gllogjani anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Pejë, paraqitur **Komisionit Komunal Zgjedhore (KKZ)**, në Pejë, për shkak të ndërrimit të vendvotimeve të komisionereve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.252/2017 e parashtruar nga subjekti politik LDK dega Pejë

A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LDK dega në Pejë të dorëzuar nëpërmjet postes me datën 07.06.2017 në të cilën pretendohet se KKZ në Pejë nuk e ka pranuar listën e LDK-së për komisioner pa bazë ligjore shumicës së komisionereve të LDK-së ju ka ndërruar vendvotimi dhe disa vendvotime janë pa komisioner të LDK-së, që është e qëllimshme dhe tendenc për vjedhje të votës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, në kuptim të nenin 117 par.3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar ndonjë dëshmi apo provë materiale e cila do të vërtetonte pretendimet e tij, edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës andaj, PZAP-i në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.252 /2017 më datën 12.06.2017

Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.